



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES : REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prillogje Në/Dana 03-05-2024 vll.god			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vendime*
12-	035/02-		687



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Arian Alidema (anëtar), Fatlum Demiri (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 03.05.2024, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ “KFF Presingu” me Nr.12-320/04-13328, e datës 26.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e OJQ “KFF Presingu” me Nr.12-320/04-13328, e datës 26.04.2024 kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024

## Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 03.05.2024 shqyrtoj ankesën e OJQ “KFF Presingu” me Nr.12-320/04-13328, e datës 26.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për paknaqësinë me përkrahjen që i është bërë në lidhje me shumën financiare të miratuar nga komisioni vlerësues, sepse e njëjta nuk i përmbush arritshmëritë e parapara të projektit tonë si klub, duke pretenduar se është në nivelin më të lartë garues në futbollin e Kosovës, duke i zhvilluar aktivitetit në nivelet të larta të garave ku përfshihen kampionatin e Superligës për të rritur dhe U17.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstatoj se, ankesa e ankuesit OJQ “KFF Presingu” është e pabazuar, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 03.05.2024 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ “KFF Presingu”.
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës e OJQ “KFF Presingu” me Nr.12-320/04-13328, e datës 26.04.2024 konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- Komisioni vlerësues ka respektuar neni 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar

konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikuesve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform nenit të cekur më lartë.

- Komisioni i ankesave konsideron dhe vlerëson se komisioni për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësuar e analizuar aplikacionin e OJQ "KFF Presingu" ka vendosur drejt, sipas thirrjes publike, bugjetit të Drejtorisë së DKRS-ë, në përputhje me procedurën sipas Rregullores 04/2017 dhe është në diskrecionin e komisionit vlerësues mbështetja financiare bazuar në aplikacionin dhe aktivitetet e parapara të OJQ "KFF Presingu".

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kritere të qarta, duke respektuar dyshkallëshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese;
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale;

Viti, më 03.05.2024

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Arian Alidema, anëtar

Fatlum Demiri, anëtar

